



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA KOMERCIALE

Numri i lëndës: 2023:302503

Datë: 28.06.2024

Numri i dokumentit: 05874569

KPPP.nr.2244/23

GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS, Dhomat e Shkallës së Parë, Departamenti për Çështje Ekonomike, Gjyqtarja Verona Dibra, në çështjen juridike përmbarimore të kreditorit “Kema Company” SH.P.K., me NUI: 810382309, me seli në Lipjan, me adresë tek QMI-ja, kundër debitorit Komuna e Prishtinës, me seli në Prishtinë, rruga “UÇK” nr.2, duke vendosur lidhur me prapësimin e debitorit të ushtruar kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.710/2023 të datës 20.11.2023, të Përmbaruesit Privat Sheremet H. Livoreka, me seli në Ferizaj, jashtë seancës, me datë 28.06.2024, merr këtë:

A K T V E N D I M

- I. REFUZOHET në tërësi si i pabazuar prapësimi i debitorit Komuna e Prishtinës, i paraqitur kundër Urdhrit Përmbarimor P.nr.710/2023 të datës 20.11.2023, të Përmbaruesit Privat Sheremet H. Livoreka.
- II. MBETET NË FUQI Urdhri Përmbarimor P.nr.710/2023 i datës 20.11.2023, i Përmbaruesit Privat Sheremet H. Livoreka.

A r s y e t i m

Përmbaruesi Privat, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit, ka lëshuar urdhrin përmbarimor P.nr.710/2023 të datës 20.11.2023, me të cilin ka lejuar përmbarimin, në bazë të dokumentit të besueshëm - Faturës Nr. 050623-3 të datës 05.06.2023, me të cilin e ka detyruar debitorin që t’ia paguaj kreditorit shumën e borxhit kryesor në vlerë prej 10,000.00 €, së bashku me kumatën ligjore 8% në vit si dhe të gjitha shpenzimet e procedurës përmbarimore, me ndalimin e mjeteve në para të cilat debitori i ka në llogaritë bankare dhe bartjen e shumës përkatëse në llogarinë e përmbaruesit privat, si dhe me regjistrimin, sekuestrimin, vlerësimin si

dhe shitjen e sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme të debitorit deri në përmbushjen e borxhit ndaj kreditorit.

Debitori brenda afatit ligjor ka paraqitur prapësim, duke theksuar se urdhri përmbarimor është i pabazuar, i palejuar dhe i paqëndrueshëm për faktin se provat e bashkangjitura nuk paraqesin dokument të besueshëm. Tutje ka shtuar se kreditori ka bashkangjitur vetëm faturën e cila nuk i plotëson kushtet sipas nenit 22 lidhur me nenin 29 të LPP-së, andaj si e tillë nuk mund të jetë objekt i përmbarimit, pasi që e njëjta duhet të jetë e nënshkruar nga të dyja palët, të ceket afati i pagesës si dhe të dihet burimi i asaj fature, andaj fatura e cila është objekt i kësaj procedure përmbarimore përveç që nuk është e nënshkruar nga debitori, nuk e ka të specifikuar detyrimin e debitorit andaj si e tillë nuk mund të ekzekutohet. I ka propozuar gjykatës që ta aprovoj prapësimin e debitorit, ndërsa urdhrin përmbarimor ta abrogoj.

Kreditori në përgjigje në prapësim të paraqitur brenda afatit ligjor, përmes përfaqësuesit të autorizuar i ka kundërshtuar pretendimet e debitorit se fatura asnjëherë nuk është pranuar nga debitori nuk qëndrojnë pasi që fatura është dorëzuar tek debitori përmes dorëzimit fizik dhe është protokolluar nga debitori, debitori ka përmbushur detyrimin kryesor por i njëjti nuk ka përmbushur edhe kthimin e faturës në emër të kompensimit për inflacion prej 20%. Tutje ka shtuar se kreditori ka dorëzuar pranë debitorit edhe kërkesën për përmbushjen e detyrimit jashtë procedurës përmbarimore por të njëjti deri më tani nuk e kanë përmbushur detyrimin e tyre. I ka propozuar gjykatës që ta refuzoj prapësimin e debitorit, ta vërtetoj urdhrin përmbarimor si dhe ta obligoj debitorin që kreditorit t'ia kompensoj shpenzimet për përpilimin e përgjigjes në prapësim sipas TOAK-së.

Gjykata pas shqyrtimit të pretendimeve të debitorit të paraqitura në prapësim, përgjigjes në prapësim të kreditorit, si dhe vlerësimit të provave që gjenden në shkresat e lëndës, duke iu referuar dispozitave të nenit 69 dhe 71 të Ligjit Nr. 04/L-139 për Procedurën Përmbarimore, (tutje LPP), gjeti se prapësimi i debitorit është në tërësi i pabazuar, andaj të njëjtin e refuzoi dhe vendosi si në dispozitiv të këtij Aktvendimi, për shkaqet si në vijim:

Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura në bazë të së cilës është lejuar urdhri për përmbarim, i plotëson kushtet për të qenë dokument i besueshëm dhe i përmban të gjitha elementet e kërkuara në përputhje me nenin 29 dhe 37 të LPP-së.

Sipas nenit 29 par.1 të LPP-së, përcaktohet se “*Përmbarimi me qëllim të realizimit të kërkesës në të holla caktohet edhe në bazë të dokumentit të besueshëm*”, me paragrafin 3 të po të njëjtit nen, përcaktohet se: “*Dokumenti i besueshëm është i përshtatshëm për përmbarim po qe se në të është treguar kreditori dhe debitori, si dhe objekti, lloji, shuma dhe koha e përmbushjes së detyrimit monetar*“, ndërsa me nenin 37 të LPP-së, përcaktohet se “*Kur propozimi për përmbarim paraqitet në bazë të dokumentit të besueshëm, mjafton që propozimit t’i bashkëngjitet dokumenti i tillë origjinal apo kopja e tij e vërtetuar sipas ligjit.*”, dhe sipas nenit 29 paragrafit 1 nën paragrafit 1.3 të LPP-së, fatura është përcaktuar si dokument i besueshëm sipas të cilit mund të caktohet përmbarimi për realizimin e kërkesës në të holla.

Në rastin konkret gjykata vlerëson se urdhri i lejuar nga ana e përmbaruesit privat bazohet në dokumentin e besueshëm - përkatësisht Faturën Nr. 050623-3 të datës 05.06.2023, e cila i përmban të gjitha tiparet e dokumentit të besueshëm sipas nenit 29 par. 3 të LPP-së, meqenëse në këtë faturë, janë treguar palët, përkatësisht kreditori dhe debitori, janë të përshkruara mallrat të cilat kanë qenë objekt i faturës, si dhe është përcaktuar shuma e cila është detyrim për përmbushje nga ana e debitorit.

Rrjedhimisht, Gjykata vlerëson se në rastin konkret fatura i plotëson kushtet e përcaktuara në nenin 37 të LPP, për zbatimin e përmbarimit në bazë të dokumentit të besueshëm, pasi që e njëjta është dorëzuar në origjinal, mban vulën e protokollimit nga ana e debitorit, si dhe nuk është kontestuar asnjëherë nga debitori.

Në rastin konkret rezulton se: Fatura Nr.050623-3 në vlerën prej 10,000.00 €, është lëshuar nga ana e kreditorit me datën 05.06.2023 dhe e njëjta është pranuar nga debitori në mënyrë të rregullt, e cila vërtetohet nga vula e pranimit e datës 01.06.2023 dhe numri i protokollit Nr. 06-422/01-111618.

Andaj bazuar në të lartcekurat, gjykata vlerëson se në rastin konkret nuk ekziston asnjëra nga bazat ligjore mbi bazën e të cilave do të mund të anulohet urdhri për lejimin e përmbarimit nga shkaqet e parashikuara në nenin 71 të LPP-së, ndërsa në kuptim të nenit 73 të LPP-së, lidhur me prapësimin e debitorit ka vendosur jashtë seancës gjyqësore.

Nga arsyet e paraqitura më lart dhe duke u bazuar në nenin 71 dhe 73 të LPP-së, nenin 13 par.1 nën par 1.2 të Ligjit nr. 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA KOMERCIALE E KOSOVËS**

Dhomat e Shkallës së Parë-Departamenti për Çështje Ekonomike

KPPP.nr.2244/23, datë 28.06.2024

Gjyqtarja

Verona Dibra

**KËSHILLA JURIDIKE:** Kundër këtij aktvendimi palët kanë të drejtë ankese në afat prej shtatë (7) ditëve, nga dita e pranimi të aktvendimit, në Dhomat e Shkallës së Dytë, në Gjykatën Komerciale të Kosovës, përmes Dhomave të Shkallës së Parë të kësaj Gjykate.